



## **Raport i Vlerësimit të Avokatit të Ankesave**

Mbi shqetësimet e komunitet në lidhje me  
Projektin e Kurum-it (Projekti i IFC-së #33378)  
në Shqipëri

Shtator 2015

Zyra e Avokatit të Ankesave, Këshilltarit dhe Përputhshmërisë (CAO)  
*Për Korporatën Financiare Ndërkombëtare dhe  
Agjencinë për Garancinë e Investimeve Shumëpalëshe*  
[www.cao-ombudsman.org](http://www.cao-ombudsman.org)

## Rreth CAO-s

Zyra e Avokatit të Ankesave, Këshilltarit dhe Përputhshmërisë (CAO)<sup>1</sup> është mekanizmi i pavarur i përgjegjshmërisë për Korporatën Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Agjencinë për Garancinë e Investimeve Shumëpalëshe (MIGA), degë të sektorit privat të Grupit të Bankës Botërore. CAO raporton drejtpërdrejt te President i Grupit të Bankës Botërore dhe mandati i Zyrës është të ndihmojë në trajtimin e ankesave nga njerëzit e ndikuar nga projektet e financuara nga IFC/MIGA, në një mënyrë që është e drejtë, objektive dhe konstruktive dhe të përmirësojë rezultatet shoqërore dhe mjedisore të këtyre projekteve.

Për më shumë informacion, shikoni [www.cao-ombudsman.org](http://www.cao-ombudsman.org).

---

<sup>1</sup> Akronimet janë lënë në gjuhën angleze, pasi kështu njihen në literaturën financiare.  
CAO - Compliance Advisor Ombudsman  
IFC - International Finance Corporation  
MIGA – Multilateral Investment Guarantee Agency

## TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtimeve	.....	4
1. Pëmbledhje	.....	5
2. Konteksti	.....	5
2.1 Projekti		
2.2 Ankesa		
3. Përmbledhje e Vlerësimit	.....	5
4. Hapat e mëtejshëm	.....	7

## **LISTA E SHKURTIMEVE**

CAO	Zyra e Avokatit të Ankesave, Këshilltarit, Përputhshmërisë
IFC	Korporata Financiare Ndërkombëtare
MIGA	Agjencia për Garancinë e Investimeve Shumëpalëshe

## **1. Pëmbledhje**

Në qershor 2015, disa anëtarë të komunitetit të cilët jetojnë në zonën pranë Uzinës së Çelikut të Kompanisë Kurum në Shqipëri, paraqitën një ankesë në Zyrën e CAO-s. Në ankesë ngrihen shqetësime që lidhen me ndotjen e tokës dhe të ajrit nga projekti i financuar nga IFC-ja. Gjatë fazës së vlerësimit të kryer nga Zyra e CAO-s, palët shprehën vullnetin për t'u përfshirë në një proces bashkëpunues, i cili do të planifikohet dhe drejtohet nga mekanizmi i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të CAO-s. Raporti i Vlerësimit paraqet një përmblendje të procesit vlerësues, si dhe një përshkrim të projektit, ankesës, metodologjinë e vlerësimit dhe hapat e mëtejshëm.

## **2. Konteksti**

### **2.1 Projekti**

Sipas IFC-së, IFC-ja financon aktualisht një projekt të Kurum Internacional në Shqipëri. I kontrolluar nga familja turke Kurum, Grupi Kurum operon në industrinë e hekurit dhe çelikut me vizionin për ta zgjeruar aktivitetin e tij dhe në biznese të tjera që lidhen me këtë industri dhe në Turqi e Ballkan. Kompania e prodhimit të çelikut ka fituar tenderin për 4 hidrocentrale – Ulëz, Shkopet, Bistrica I dhe Bistrica II, që ishin privatizuar nga qeveria shqiptare në vitin 2012.

Projekti do të shërbejë për të financuar (i) blerjen e hidrocentraleve; dhe (ii) investimet për rehabilitimin e këtyre hidrocentraleve në shumën e vlerësuar në 10 milion Euro. Grupi synon të shfrytëzojë hidrocentralet për të siguruar energji të rinovueshme të pandërprerë për uzinën ekzistuese të çelikut. Përmes këtij projekti, Kurum parashikon reduktimin e kostove të tij për blerjen e energjisë elektrike, dhe sigurimin e burimit të vazhdueshëm të energjisë elektrike për të vazhduar aktivitetin pa ndërprerje të mëdha. Projekti është klasifikuar në Kategorinë e Mjedisit B.

### **2.2 Ankesa**

Në qershor 2015, në Zyrën e CAO-s u paraqit një ankesë nga disa banorë të cilët jetojnë në afërsi të Uzinës së Çelikut Kurum në Elbasan, Shqipëri. Ankuesit ngrenë shqetësimet e tyre në lidhje me ndotjen e ajrit dhe të tokës të shkaktuar nga aktiviteti i uzinës, dhe ndikimin që mund të ketë kjo në shëndetin e banorëve. Në seksionin 3 paraqitet një përshkrim më i detajuar i çështjeve që ngrihen në ankesë.

Një version i redaktuar i ankesës mund të gjendet në faqen e internetit të CAO-s në linkun e mëposhtëm: [http://www.cao-ombudsman.org/cases/case\\_detail.aspx?id=237](http://www.cao-ombudsman.org/cases/case_detail.aspx?id=237).

## **3 Përmblendje e vlerësimit**

Qëllimi i fazës vlerësuese nga CAO është qartësimi i çështjeve dhe shqetësimeve të ngritura nga ankuesit, mbledhja e informacionit se si perceptohet situata nga palë të tjera të përfshira, veçanërisht nga Kurumi, dhe për të vendosur se çfarë i kërkohet CAO-s që të bëjë në vazhdim.

Gjatë fazës së vlerësimit CAO nuk mbledh informacion për të marrë vendim nëse ankesa qëndron apo jo. Për më shumë informacion në lidhje me Udhëzimet Operacionale të CAO-s ju lutem shikoni ([http://www.cao-ombudsman.org/howwework/documents/CAOOperationalGuidelines2013\\_ENGLISH.pdf](http://www.cao-ombudsman.org/howwework/documents/CAOOperationalGuidelines2013_ENGLISH.pdf)).

Faza e vlerësimit të ankesës nga CAO-s u fokusua në:

- Rishikimin e dokumentacionit të projektit;
- Takimin me ankuesit dhe vizitë në terren;
- Takimin me përfaqësuesit e Kurum-it, dhe vizitë në mjediset e Uzinës së Çelikut në Elbasan; dhe
- Takimin me ekipin e Projektit të IFC-së.

Në pjesën e mëposhtme janë përmbledhur këndvështrimet e ankuesve dhe të Kurumit në lidhje me ankesën drejtuar CAO-s. Kjo përmbledhje nuk përben një gjykim nga CAO nëse ankesa qëndron.

#### *Këndvështrimet e ankuesve*

Shqetësimi i kryesor i ankuesve lidhet me perceptimin e ndotjes nga uzina e çelikut dhe ndikimet që ata mendojnë se kjo ka në shëndetin e tyre dhe të familjeve të tyre që jetojnë në Katund të Ri dhe Bradashesh. Megjithëse ankuesit pranojnë se kompania Kurum ka bërë përmirësime në uzinë që prej marrjes në pronësi të saj në vitin 1999, ata pretendojnë se vërejnë emetime që dalin nga uzina. Ata përmendin faktin se shikojnë re tymi që krijohen nga uzina, veçanërisht natën ose herët në mëngjes, se nuhasin elementë kimikë të rëndë në ajër, dhe se vërejnë ndotje mbetjesh që grumbullohen në pellgje pasi bie shi. Ata shprehen se ka pasur një rritje në problemet shëndetësore (sëmundje të mushkërive dhe të gjakut), dhe se kjo reflektohet në të dhënat e spitalit.

Ankuesit ngrenë pyetje rreth operacioneve të Kurumit, dhe pretendojnë se nuk kanë akses në informacion të disponueshëm, të kuptueshëm dhe të besueshëm se si uzina e çelikut e menaxhon problemin e ndotjes. Pyetjet e tyre fokusohen në të kuptuarin më të mirë të orëve dhe kushteve të operacioneve, përmbushjen e standardeve europiane dhe standardeve të tjera të zbatueshme, dhe teknologjinë e duhur (filtrat, materialet djegëse, burimet e energjisë, përdorimin e ujit gjatë procesit të copëtimit të skrapit, etj) që nevojiten për të menaxhuar ndotjen, dhe nëse Kurumi përdor gjithnjë të njëjtën teknologji. Ankuesit pranojnë rëndësinë ekonomike të uzinës së çelikut për zonën dhe se nuk kërkojnë mbylljen e saj. Ata do ta mirëprisnin mundësinë për të diskutuar me Kurumin për çështjet që ata kanë ngritur në ankesë.

#### *Këndvështrimi i Kurumit*

Nga këndvështrimi i kompanisë, ata tregojnë se kanë bërë investime të konsiderueshme në teknologji që kjo të jetë në përputhje me standardet europiane, si dhe të IFC-së për emetimet në atmosferë. Kompania raporton se ka marrë disa masa ndër vite - për shembull instalimi i filtrave, investimi për impiantin e eliminimit të pluhurit dhe në mbajtjen e shufrave të nxehta ndërkohë që dërgohen në repartin e petëzimit – që ndër të tjera janë bërë dhe me qëllim për të pakësuar emetimet në ajër dhe këto janë bërë në mënyrë konsistente. Kurumi më tej deklaroi se ata i raportojnë rregullisht të dhënat për emetimet në atmosferë te institucionet shqiptare dhe te huadhënësit e tyre, si dhe i publikojnë të dhënat në mediat kryesore.

Kurum e kupton se njerëzit mund të kenë keqkuptime apo perceptime të gabuara në lidhje me operacionet e kompanisë dhe emetimet, si për shembull ngatërrimi i avujve të ujit të çliruar gjatë procesit me emetimet. Edhe pse kompania është e shqetësuar për mënyrën se si media mund të përdoret për të shkallëzuar ose për t'i ekzagjeruar çështjet, ata shprehen se kompania është e hapur për të komunikuar me të gjithë aktorët për të shkëmbyer informacion në lidhje me

operacionet e saj dhe planet e saj për zbutjen e ndotjes. Kompania u shpreh se po punon për pëmirësim e planit të saj për angazhimin e palëve të interesuara dhe për ta bërë komunikimin dhe të dhënat më të aksesueshme për publikun.

Në lidhje me ankesën specifike drejtuar CAO-s, Kurumi shprehu vullnetin për të komunikuar me ankuesit përmes një procesi të drejtuar nga CAO.

#### **4 Hapat e mëtejshëm**

Të dyja palët shprehën vullnetin e tyre për t'u përfshirë në një proces vullnetar të dialogut të drejtuar nga CAO. CAO do të lehtësojë procesin dhe, si hap fillestar, do të komunikojë me palët për të vendosur se si do të strukturohet procesi. Kjo, ndër të tjera, do të përfshijë një marrëveshje në lidhje me çështjet e diskutuara, strukturën e takimeve, rregullat e komunikimit, nëse kjo është relevante.